

AKT NORMATIV
Nr. 9, datë 1.10.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007,
“PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E
KUNDËRLIGJSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës “b”, të nenit 3, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KKTU-së, për lejet në kompetencë të KKTU-së, e cila bashkërendon procesin e kontrollit e monitorimit me strukturat përgjegjëse për inspektimin.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Për shkeljet e lejeve të ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, vendos gjoba me propozim të Sekretariatit Teknik të KKTU-së, apo të strukturës përgjegjëse qendrore për inspektimin;”.

2. Pas shkronjës “f” shtohen shkronjat “g” dhe “gj”, me këtë përmbajtje:

“g) Për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, vendos masat sipas shkronjave “b”, “ç”, “d”, “dh” dhe “ë” pasi bashkërendon procesin e kontrollit e të monitorimit me Sekretariatit Teknik të KKTU-së;

gj) Për të gjitha lejet e ndërtimit në proces zbatimi, të dhëna nga organet përgjegjëse për zhvillimin e territorit, struktura përgjegjëse për inspektimin pranë njësive vendore, për çdo leje ndërtimi, përcakton të paktën një inspektor, i cili do të jetë personi përgjegjës, që ka për detyrë të monitorojë dhe të kontrollojë periodikisht zbatimin e ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, gjatë të gjithë procesit të zbatimit të punimeve deri në kolaudimin përfundimtar të ndërtimit.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) ushtron kontrollin/inspektimin, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e territorit dhe të peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, ushtron përgjegjësitë e veta në nivel

njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet, që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e planifikimit e zhvillimit të territorit, disiplinimit të punimeve në ndërtim dhe produkteve të ndërtimit, mbrojtjes së tokës, ajrit, ujërave, pyjeve dhe zonave të mbrojtura natyrore, monumenteve natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kryen, gjithashtu, inspektimin e instalimeve të tipave A dhe B, inspektimin mjedisor dhe në territor për zonat e mbrojtura, objektet e trashëgimisë kulturore, zonat arkeologjike, zonat me përparësi turizmin dhe brezin bregdetar, lagunat, lumenjtë, liqenet, tokat bujqësore, spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, objektet infrastrukturore kombëtare, burimet dhe rrjetet minerare natyrore, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastrukturat mbështetëse, sektorin e energjisë dhe të komunikimit elektronik, aeroportet, portet dhe rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, sipas përcaktimeve ligjore në ligjin e posaçëm dhe në atë për inspektimin, si dhe në vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit;”.

2. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe të ligjit për kontrollin e disiplinimit e punimeve të ndërtimit nga struktura përgjegjëse e inspektimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe merr masat përkatëse në zbatim të ligjit.”.

3. Pas shkronjës “dh”, të nenit 9, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU-së bashkërendon procesin e kontrollit me Sekretariatit Teknik të KKTU-së.”.

Neni 4

Në nenin 9/1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “a”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) kërkohet nga vetë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore ose nga kryetari përkatës i saj, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor, apo kërkohet nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KKTU-së, për lejet në kompetencë të KKTU-së.”.

2. Në pikën 4, fjala “... planifikimit ...” zëvendësohet me “... zhvillimit ...”.

Neni 5

Pas shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 9/2, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) me kërkesën me shkrim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.”.

Neni 6

Pika 1, e nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për ushtrimin e përgjegjësiave dhe të detyrave të parashikuara në këtë ligj, struktura përgjegjëse qendrore dhe struktura përgjegjëse për inspektimin pranë njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se tre inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje dy inspektorë të trupës inspektuese të strukturës përgjegjëse qendrore dhe një inspektor të trupës inspektuese të strukturës përgjegjëse për inspektimin pranë njësisë vendore. Për kontrollin e lejeve të ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, strukturës i shtohen edhe dy persona përgjegjës me rol mbështetës nga drejtoria e monitorimit pranë AZHT-së.”.

Neni 7

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga mbajtja e procesverbalit të inspektimit nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimit, ku reflektohen gjetjet, që përbëjnë kundërvajtje administrative, të cilat ndëshkohen me gjobë dhe me dënime të tjera plotësuese, sipas përcaktimeve ligjore në ligjin e posaçëm, nëse është rasti, trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe/ose trupa inspektuese e inspektoratit vendor të mbrojtjes së territorit nxjerr vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimit, për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga trupa inspektuese.

Përfundimisht nga sa më sipër, kur subjekti i inspektimit ka kryer shkelje ligjore të konstatuara në kushtet e flagrancës, për gjetjet e pasqyruara në procesverbalet e konstatimit, të cilat sanksionohen me masën administrative me gjobë dhe me dënime të tjera plotësuese si dënim me vendim prishjeje etj., sipas përcaktimeve ligjore në ligjin e posaçëm, trupa inspektuese merr menjëherë vendim përfundimtar, i cili nënshkruhet nga Kryeinspektori, nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimit në vend, pa qenë të detyruar të zbatojnë afatin 10-ditor të marrjes së vendimit përfundimtar, sipas parashikimit të bërë më sipër. Vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit të inspektimit nëpërmjet postës elektronike apo nëpërmjet shërbimit postar.

2. Në rastet kur kundërvajtjet administrative të gjetura ndëshkohen me pezullim të punimeve dhe prishje të objektit, trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe/ose vendor nxjerr vendimin përfundimtar të inspektimit për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

Dënimi me pezullim të punimeve në ndërtim merret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak për marrjen e vendimit përfundimtar për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës ose për marrjen e vendimit me dënimin për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim zgjat deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Një vendim i tillë merret në rastet kur:

a) subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet trupës së inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit/zhvillimit, që ka të bëjë, sipas rastit, me projektimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe/ose kolaudimin e punimeve të ndërtimit;

b) plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;

c) vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare;

ç) nuk është dorëzuar dosja pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin pranë njësisë vendore, para fillimit të punimeve në objekt;

d) mungon inxhinieri mbikëqyrës i punimeve, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi;

dh) mungon tabela me informacionet përkatëse të objektit;

e) mungon çdo akt sipas legjislacionit në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim;

ë) mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;

f) konstatohet shkelje me cilindo nga parashikimet e bëra në rregulloren e zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe me ligjin për kontrollin dhe disiplinimin punimeve të ndërtimit.

Dënimi me pezullim të punimeve në ndërtim, sipas rasteve të listuara në shkronjat e kësaj pike, shoqërohet me dënim me gjobë dhe/ose konfiskim, sipas parashikimeve ligjore, si dhe, kur përbën vepër/kundërvajtje penale, trupa inspektuese qendrore/vendore referon kallëzimin penal në organet ligjzbatuese dhe/ose kërkesën për heqje të licencës të subjektit kundërvajtës, nëse është rasti.

Gjatë periudhës së pezullimit të punimeve në ndërtim, subjekti ndërtues është i detyruar të ndërpresë punimet në objekt dhe inspektorati vendor përkatës është përgjegjës për zbatimin e këtij dënimi.

Në rastet kur dënimi merret nga trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror/rajonar, kjo e fundit i dërgon brenda 5 (pesë) ditëve vendimin e pezullimit inspektoratit vendor, i cili e zbaton atë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.

3. Në rastet e vendosjes së strukturave lehtësisht të çmontueshme, të cilat nuk bëjnë pjesë brenda brezit bregdetar, në zonat e mbrojtura apo në zonë kufizuese të një monumenti kulture, të realizuara në mungesë të deklaratës paraprake të punimeve nga organet përkatëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, trupa inspektuese qendrore/vendore paraprakisht aplikon dënimin kryesor administrativ me paralajmërim. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve, që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar në ligjin e posaçëm dhe në metodologjinë e përcaktimit të masave administrative, nëse është e nevojshme, si dhe të paraqesë edhe provat, që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri nga trupa inspektuese. Në rast moszbatimi nga ana e subjektit, inspektimi vijon sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji.

Përfshihet nga sa më sipër, në rastet e vendosjes së strukturave lehtësisht të çmontueshme, të cilat bëjnë pjesë brenda brezit bregdetar, në zonat e mbrojtura apo në zonë kufizuese të një monumenti kulture, të realizuara në mungesë të lejes së ndërtimit/deklaratës paraprake të punimeve nga organet përkatëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, sipas ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, struktura inspektuese qendrore/vendore aplikon si dënim kryesor gjobën dhe, si dënim plotësues, vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Për shkeljet e konstatuara në fushën e tregtimit e të prodhimit të produkteve të ndërtimit, trupa inspektuese qendrore aplikon paraprakisht dënimin kryesor administrativ me paralajmërim. Dënimi administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve, që pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar në ligjin e posaçëm dhe në metodologjinë e përcaktimit të masave administrative, si dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri nga trupa inspektuese. Në rast moszbatimi nga ana e subjektit, inspektimi vijon sipas parashikimeve të nenit 12 të këtij ligji.

4. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e inspektimit, të planifikimit, të zhvillimit, të mbrojtjes së territorit, si dhe, në të gjitha rastet, kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet

dokumentacioni teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë për kundërvajtësin, si dhe, kur përbën vepër/kundërvajtje penale, trupa inspektuese qendrore/vendore referon kallëzimin penal në organet ligjzbatuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 8

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ankimi administrativ nuk pezullon ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të trupave inspektuese sipas këtij ligji. Vendimi përfundimtar është i ekzekutueshëm menjëherë me njoftimin e tij subjektit të inspektuar. Autorizimi i inspektimit dhe procesverbali i inspektimit nuk mund të ankimohen veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.”.

2. Paragrafi i fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ankimi gjyqësor mund të ushtrohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shterimi i ankimit administrativ dhe nuk pezullon ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të trupave inspektuese sipas këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 15

1. Veprimet ose mosveprimet e kryeinspektorëve/inspektorëve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve të IKMT-së, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale ose jo, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë vijon:

a) Mosushtimi i funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në masën 300 000 lekë.

b) Shtrembërimi i rezultateve të kontrollit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, në masën 400 000 lekë.

c) Mosrespektimi i afateve për marrjen e vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 200 000 lekë.

ç) Mosrespektimi i afateve të zbatimit të vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 300 000 lekë.

d) Moszbatimi i vendimit të pezullimit të punimeve në ndërtim brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, në masën 150 000 lekë.

dh) Mosrespektimi i afatit për dhënien e informacionit dhe pengimi në përmbushjen e detyrave, në masën 100 000 lekë.

e) Mosparaqitja e kërkesës për heqje licence të mbikëqyrësit të punimeve pranë organeve kompetente, në masën 500 000 lekë.

2. Gjoha vendoset me vendim të kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe përbën titull ekzekutiv.

3. Në rastet kur ka një denoncim nga strukturat e IKMT-së, Policisë së Shtetit, apo nga vetë qytetarët për një ndërtim të kundërligjshëm, si dhe provohet mosveprimi me faj i kryeinspektorit/inspektorëve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, ndaj këtyre të fundit merret masa e menjëhershme e largimit nga detyra.

4. Në rastet kur ekzistojnë kushtet sipas pikës 3, të këtij neni, IKMT-ja përgatit kallëzimin penal dhe e depoziton atë pranë organeve kompetente, me qëllim fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të inspektorit dhe Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore.”.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama